LIGJ
Nr.10 375, datë 10.2.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8750, DATË 26.3.2001 "PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN NDAJ TRAFIKUT TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE OSE PSIKOTROPE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8750, datë 26.3.2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 paragrafi i dytë dhe kudo në ligj fjalët "Ministri i Rendit Publik" zëvendësohen me fjalët "ministri përgjegjës për rendin publik".

Neni 2

Në nenet 17 dhe 18 fjalët "me nenin 40 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit"" zëvendësohen me fjalët "me dispozitat e ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit"".

Neni 3

Pas nenit 28 shtohet neni 28/a me këtë përmbajtje:

"Neni 28/a

Institucioni që kryen ekspertimin, pas përfundimit të ekspertimit të substancës narkotike ose psikotrope, së bashku me aktin e ekspertimit i dërgon organit procedues që ka kërkuar ekspertimin edhe mostrën e ekspertuar.

Rregulla më të hollësishme për afatet, procedurën dhe mënyrën e dërgimit të substancave narkotike ose psikotrope të ekspertuara përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit që ka në varësi institucionin që kryen ekspertimin dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.".

Neni 4
Dispozitë kalimtare

1. Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Drejtoria e Policisë Shkencore, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, inventarizojnë mostrat e substancave narkotike dhe psikotrope, të ekspertuara prej tyre, sipas çështjes penale përkatëse.

2. Në përfundim të procesit të inventarizimit, sipas pikës 1 të këtij neni, Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe Drejtoria e Policisë Shkencore njoftojnë drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, të cilët marrin masat për asgjësimin e substancave narkotike dhe psikotrope ose për kryerjen e veprimeve, sipas disponimit të gjykatës në vendimin përfundimtar.

3. Asgjësimi i substancave narkotike dhe psikotrope, i parashikuar në këtë nen, realizohet sipas rregullave të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6903, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi